



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 30 Mars 2021

Nr: 13

VENDIMI

“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 07 DATË 25.03.2021, TË KOALICIONIT BASHKIMI POPULLOR – EMIGRACIONI – ORA E SHPRESËS DHE KONSERVATORËT ME OBJEKT “KUNDËRSHTIMIN E VENDIMIT NR. 172, DATË 23.03.2021 “PËR CAKTIMIN E SASISË SË FONDIT NGA BUXHETI I SHTETIT QË DO TU SHPËRNDAHEN SI PARADHËNIE PARTIVE POLITIKE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021” TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 30.03.2021, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO - Kryesues
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Ilijar RUSMALI - Anëtar
Koli BELE - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

Ankues : Koalicioni Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët, (ABEOK) përfaqësuar nga z. Shpëtim Kodhelaj;

OBJEKTI: Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 07 të koalicionit Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 172, datë 23.03.2021 “për caktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do tu shpërndahen si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 86 shkronja “a”, 88 dhe 180 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Rrethanat e çështjes:

Ankimuesi, koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) (në vijim koalicioni ABEOK), me vendimin nr. 117, datë 08.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”, në zbatim të neneve 65 dhe 66 të K.Zgjedhor, është regjistruar si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, me parti pjesëtare të tij, si më poshtë:

1. Partia Kombëtare Konservatore Albania;
2. Partia Ora e Shqipërisë;
3. Partia Emigracioni Shqiptar; dhe
4. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar;

Në vijim, koalicioni ABEOK, në zbatim të nenit 67 të K.Zgjedhor, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve listat e kandidatëve të koalicionit, lista këto që janë miratuar me vendimin nr. 167, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e listave shumemërore të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”. Miratimi i listave të kandidatëve është faza përfundimtare që garanton se një subjekt zgjedhor do të jetë pjesëmarrës në zgjedhjet përkatëse, në rastin konkret në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.

Pas vendimmarrjeve në lidhje me miratimin e listave shumemërore të partive politike dhe koalicioneve që përcaktojnë dhe subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të neneve 86, 88 dhe 180 të K.Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 3, datë 16.02.2021 “Për miratimin e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, ka marrë vendimin nr. 172, datë 23.03.2021 “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021” nëpërmjet të cilit, ndër të tjera ka vendosur “*Të shpërndajë si*

paradhënie, fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi”. Në lidhjen 1 bashkëlidhur vendimit gjendet tabela si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi i partisë politike	Fondi që përfitohet (lekë)
1	Partia Demokratike (PD)	33,318,149
2	Partia Republikane (PR)	3,926,232
3	Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK)	1,434,012
4	Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)	55,826,750
5	Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)	18,975,182
6	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU)	5,552,885
7	Partia Fryma e Re Demokratike (FRD)	2,188,832
8	Partia Demokristiane (PDK)	1,479,742
9	Partia Social Demokrate (PSD)	1,629,360
10	Partia Bindja Demokratike	1,485,550
TOTAL		125,816,694

Në arsyetimin e kësaj vendimmarrje, ndër të tjera, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka arsyetuar se:

“Fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, referuar pikës 4, të nenit 180 të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit, është 2 herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. Fondi i vënë në dispozicion në vitin zgjedhor 2017 ishte 65,000,000 lekë, pra rrjedhimisht llogaritet që për vitin zgjedhor 2021 të jetë 130,000,000 lekë. Në nenin 180 “Dispozitë tranzitore për financimin nga buxheti” përcaktohet se për zgjedhjet e para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përllogaritjet e shpërndarjes së fondeve paradhënie do të bëhen në bazë të rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore 2015 dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

Referuar paragrafit 2 të nenit 180 të Kodit Zgjedhor në përllogaritje do të përfshihen edhe subjektet zgjedhore të cilat nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje por që kanë marrë pjesë në zgjedhjet vijuese dhe plotësojnë kushtin e tejkalimit të kufirit prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara prej tyre. Pas përllogaritjes, numri i votave të vlefshme është 1,780,854. Rezultati 72.998 lekë (73), është vlere në para e një vote të vlefshme.

Në përlllogaritjen e vlerës së votës janë përfshirë edhe partitë politike të cilat kanë plotësuar kushtin e tejkalimit të kufirit prej 1% por që nuk do të përfitojnë fonde për shkak të mosregjistrimit të tyre në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021. Respektivisht:

1. Partia Demokratia Sociale (PDS)	20.064 vota	1.28%
2. Partia Socialiste e Vërtetë 91 (PSV91)	17.465 vota	1.12%
3. Partia Lista e Barabartë (LIBRA)	19.806 vota	1.25%

Për sa më sipër, referuar paragrafit 3 të nenit 88, KQZ-ja përlllogarit shumën që i takon secilës parti duke shumëzuar vlerën në para të një vote me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet pararendëse siç përcakton dispozita tranzitore”.

Ndaj këtij vendimi, në zbatim të nenit 124 të K.Zgjedhor, ka paraqitur ankim koalicioni ABEOK i cili në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 07 regj, datë 25.03.2021.

Në zbatim të nenit 12 të Rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, në datë 26.03.2021 është hedhur shorti për të caktuar relatorin e shqyrtimit të kësaj kërkesë ankimore, nga i cili u caktua relator anëtari Ledio Braho.

Në seancën e datës 29.03.2021 e cila ishte seancë e verifikimit paraprak KAS vendosi “Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 07, datë 25.03.2021, të paraqitur nga koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK)”. Në vijim, në datë 30.03.2021, KAS zhvilloi seancën publike të shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore nr. 07, datë 25.03.2021 të paraqitur nga koalicioni ABEOK në prani të përfaqësuesit të koalicionit dhe administratës së KQZ.

Në ankimin e paraqitur nga koalicioni ABEOK, ndër të tjera, argumentohet se:

- KQZ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj dhe në K.Zgjedhor, nuk financon nga fondet e buxhetit të shtetit partitë politike pjesë e koalicionit ABEOK;
- Nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk është marrë parasysh vendimi i KQZ me nr. 555, datë 26.07.2017, vendim i cili ka shpallur rezultatet për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Qershor 2017;
- Shuma që përfiton secila parti sipas nenit 19, pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, përcaktohet në një mënyrë: shuma prej 98 milionë lekë e cila përbën 70% të shumës totale për tu shpërndarë prej 140 milionë lekësh, i shtohet edhe shuma prej 345,800 lekë e cila mbetet pa u shpërndarë nga 10% i shumës totale. Totali prej 98,345,800 lekë pjesëtohet me numrin e deputetëve të Parlamentit shqiptar prej 140 deputetësh. Rezultatit 702,470 lekë është shuma që përfiton partia politike për çdo deputet që ka në Kuvend.

- Subjektet zgjedhore përfitojnë financime nga fondet publike, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod. Sasia e fondeve publike që do t'u shpërndahen subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të Kuvendit së bashku me buxhetin e zgjedhjeve, sipas nenit 86 të këtij Kodi;
- Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit prej subjekteve zgjedhore caktohet me vendim të KQZ-së, sipas rregullave të mëposhtme: a) 50% e shumës ndahet ndërmjet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe që kanë mandate në Kuvend, e përcaktuar kjo sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. Kjo shumë u jepet këtyre partive politike nga KQZ-ja jo më vonë se 5 ditë pas regjistrimit të tyre si subjekt zgjedhor dhe paraqitjes së listës shumëmemërore për çdo zonë zgjedhore. Shuma shpërndahet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin; b) 50% e shumës së përgjithshme ndahet midis partive.

Gjatë seancës publike të shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore, përfaqësuesi i koalicionit ABEOK, ngriti pretendime për analogji për përfshirjen e partisë Bindja Demokratike si subjekt zgjedhor që përfiton fonde nga buxheti i shtetit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Referuar sa më sipër, ankuesi kërkon pranimin e kërkesës ankimore kundër vendimit nr. 172, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e KQZ, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të financojë koalicionin ABEOK, bazuar në vendimin nr. 555, datë 26.07.2017 të KQZ dhe ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, përkatësisht neni 19 pika 2 gërmat “a” dhe “b” të tij.

Në seancën publike për shqyrtimin administrativ të kësaj kërkesë ankimore, KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- o Kërkesën Ankimore nr. 07, datë 25.3.2021 të koalicionit ABEOK së bashku me parashtrimet e depozituara në seancën publike të datës 30.03.2021;
- o Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 172, datë 23.03.2021 “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t'u shpërndahet si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”;
- o Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 24, datë 02.02.2021 “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2021”;
- o Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 117, datë 08.03.2021 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021”;

- o Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 167, datë 18.3.2021 “Për miratimin e listave shumemërore të koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor - Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”;
- o Vendimin nr. 555, datë 26.07.2017 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017” së bashku me lidhjet bashkëlidhur;
- o Vendim nr. 965, datë 10.08.2015 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015” së bashku me lidhjet bashkëlidhur;
- o Dokument shkresor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me titull “Zgjedhjet Vendore 2019 – Të dhënat për Votat e Vlefshme për Kandidatët për Këshill në Rang Vendi”¹

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve konstaton se:

Pas vlerësimit të pretendimeve të ngritura nga ankimuesi në ankim dhe në seancë publike dhe të provave në tërësi, ankimi është i pambështetur në ligj dhe në prova e për rrjedhojë duhet të rrëzohet.

1. Në kërkesën ankimore të koalicionit ABEOK, në pikën dy të saj citohet kundërshtimi i *“projektvendimit për caktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”* duke cituar edhe numrin dhe datën e aktit që kundërshtohet (nr. 172, datë 23.03.2021). Për këtë arsye, për KAS është e qartë edhe në vijim të seancës publike të zhvilluar në lidhje me këtë kërkesë ankimore, që objekt ankimi është vendimi nr. 172, datë 23.03.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Në pikën një të kërkesës ankimore koalicioni ABEOK e ngre pretendimin e tij bazuar në nenin 19 pika 2 shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar.
3. Në kuadër të pretendimit të ngritur nga ankimuesi dhe vendimit objekt ankimi, KAS gjen me vend që si fillim të interpretojë dy institutet e ndryshme të financimit të partive politike nga Buxheti i Shtetit që janë a) Ndhima financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike dhe b) Fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore (për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje).

¹ Nuk ka vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet vendore të datës 30 Qershor 2019 për shkak të mosformimit të kuorumit në KQZ, shkak ky që solli si pasojë edhe shpërndarjen e mandateve nga Kolegji Zgjedhor.

- Në lidhje me fondin që përbën ndihmën financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike, është neni 19 i ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar që rregullon mënyrën e ndarjes së tij. Më konkretisht, pikat 2 dhe 3 të këtij neni parashikojnë se:

“2. Ky fond ndahet sipas rregullave të mëposhtme:

a) 70 për qind, sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Çdo parti parlamentare përfiton ndihmë financiare në përputhje me numrin e deputetëve që ka fituar në bazë të sistemit zgjedhor të parashikuar në Kodin Zgjedhor;

b) 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive që kanë marrë mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare.

c) 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi.

Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.

3. Masa konkrete e fondit publik, që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore, në përputhje me këtë ligj, përcaktohet me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky vendim u njoftohet partive politike përfituese dhe Ministrisë së Financave”.

Në lidhje me këtë fond të përvitshëm, për vitin 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka marrë vendimin nr. 24, datë 02.02.2021 “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2021”, sipas të cilit fondi prej 140,000,000 lekë ndahet si më poshtë vijon:

NR.	EMËRTIMI I PARTISË POLITIKE	FONDI QË PËRFITOHET (LEKË)
1.	Partia Socialiste e Shqipërisë	63,417,047
2.	Partia Demokratike	38,911,877
3.	Lëvizja Socialiste për Integrim	20,012,797
4.	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	7,447,477
5.	Lista e Barabartë	4,841,667
6.	Partia Socialdemokrate	5,369,137
	Totali	140,000,000

Ndaj këtij vendimi nuk ka paraqitur ankim asnjë prej partive politike përbërëse të koalicionit ABEOK.

- Në lidhje me fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje, janë nenet 88 dhe 89 të K.Zgjedhor që përcaktojnë masën e këtij fondi dhe mënyrën e ndarjes së tij. Përjashtimisht, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, duhet t'i referohemi edhe nenit 180 të K.Zgjedhor si dispozitë tranzitore për këto zgjedhje. Më konkretisht, neni 180 i K.Zgjedhor parashikon se:

“1. Zbatimi i nenit 88 të këtij ligji për financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të tij bëhet duke kryer përllogaritjet në bazë të rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore të vitit 2015 dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

2. Për secilën parti përfshihet në përllogaritje shifra që pasqyron numrin më të lartë të votave që partia ka marrë në njërin nga këto dy zgjedhje, kur ajo është jo më e vogël se 1 për qind e votave të vlefshme në zgjedhjet përkatëse. Në përllogaritje përfshihet edhe rezultati i subjekteve zgjedhore, që nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje, por që kanë marrë pjesë në zgjedhjet vijuese dhe që plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 88 të këtij ligji për kufirin prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara prej tyre.

3. Totali i fondit buxhetor që është për t'u shpërndarë pjesëtohet me totalin e votave të përfuara nga përllogaritjet sipas pikës 2 të këtij neni. Rezultati që del formon vlerën në lekë për një votë.

4. Në zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, fondi nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje do të jetë 2 herë më i madh se fondi i alokuar për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017”.

Neni 88 i K.Zgjedhor, që për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 zbatohet vetëm për aq sa referon neni 180 i këtij kodi, parashikon se:

“1. Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave në shkallë vendi në zgjedhjet më të afërta pararendëse të të njëjtit lloj, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondi për këtë qëllim përcaktohet me vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit për vitin zgjedhor përkatës. Ky fond nuk mund të jetë më pak sesa totali i shumave të shpërndara partive politike në zgjedhjet pararendëse.

2. KQZ-ja, brenda 10 ditëve nga nxjerrja e rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, përcakton

me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme, duke pjesëtuar fondin e përgjithshëm të miratuar, me numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore llogaritja bëhet mbi bazën e votave të marra për këshillat vendorë në shkallë vendi.

3. KQZ-ja përlllogarit shumën që i takon secilës parti, duke shumëzuar vlerën në para të një vote të vlefshme, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, me numrin e votave të vlefshme që ka marrë secila parti në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj. Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlllogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre.

4. KQZ-ja zbret nga shuma e përlllogaritur, sipas pikës 3, sanksionet financiare që janë bërë titull ekzekutiv, të vëna për partinë përkatëse, sipas këtij ligji.

5. Shuma e mbetur pas përlllogaritjeve të pikës 4 është shuma që përfiton partia pjesëmarrëse në zgjedhje nga Buxheti i Shtetit.

6. Fondi i përcaktuar për t'u shpërndarë sipas këtij neni i jepet secilës parti jo më vonë se 5 ditë nga regjistrimi i listave shumemërore ose kandidatëve për kryetar të njësisive të qeverisjes vendore të partisë përkatëse. Partia politike që përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit dhe KQZ-ja, para shpërndarjes së fondit, nënshkruajnë aktmarrëveshje, në të cilën përcaktohet se partia politike pranon fondin e dhënë, se do ta përdorë atë në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, pranon monitorimin e shpenzimit të tyre prej subjektit dhe kandidatëve të tij, si dhe do të respektojë të gjitha ndalimet që përcaktohen në këtë ligj për ta. KQZ-ja përcakton me akt nënligjor modalitetet e tjera të aktmarrëveshjes që nënshkruhet mes palëve.

7. Në rast se shuma e përlllogaritur në pikën 5 të këtij neni është më e lartë se totali i shpenzimeve të fushatës zgjedhore të raportuara nga partia politike ose është vlerësuar si e tillë nga KQZ-ja sipas auditimeve të pavarura apo verifikimeve të saj, atëherë partia politike është e detyruar të kthejë diferencën në KQZ.

8. Në rast se partia politike nuk zbaton përcaktimin e bërë në pikën 7 të këtij neni, atëherë përjashtohet nga e drejta për të përfituar fonde publike për një periudhë jo më pak se 5 vjet, përveçse kur shlyen detyrimin bashkë me gjokat’.

Pikërisht, në zbatim të këtyre dy dispozitave Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka marrë vendimin nr. 172, datë 23.03.2021 duke ndarë fondin prej 13 milionë lekë si fond nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje sipas tabelës në hyrje të këtij vendimi.

4. Në lidhje me bazën ligjore ku bazon pretendimet e tij ankimesi si dhe formulën mbi të cilën bën përlllogaritjen e fondeve që i takojnë nga Buxheti i Shtetit, sqarojmë se në bazë të arsytimit të mësipërm, vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve objekt ankimi, nuk ka dalë në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” të ndryshuar, por në zbatim të neneve 88 dhe 180 të K.Zgjedhor, pra kemi të bëjmë me premisa të ndryshme vendimmarrjesh që për rrjedhojë janë fonde dhe formula të ndryshme përlllogaritjeje.
5. Megjithatë, pavarësisht bazës ligjore dhe konfondimit të pretendimeve të ankimesit në lidhje me këto dy institute të ndryshme të financimit të partive politike nga Buxheti i Shtetit, KAS, në zbatim të pikës 6 të nenit 124 të K.Zgjedhor që parashikon se “*Në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, KQZ-ja shqyrton të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërkimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor*”, mori në shqyrtim ligjshmërinë e vendimit nr. 172, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me mospërfitimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit për partitë politike përbërëse të koalicionit ABEOK.
6. Në lidhje me ligjshmërinë e vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve objekt ankimesi, KAS, siç është arsyetuar dhe më sipër, do t’i referohet neneve 88 dhe 180 të K.Zgjedhor. Në zbatim të nenit 180 të K.Zgjedhor do t’i referohemi po ashtu rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2017 dhe atyre për organet vendore për vitin 2015 dhe përjashtimit atyre të vitit 2019 për ato parti politike që nuk kanë qenë pjesëmarrëse në zgjedhjet e vitit 2015 dhe 2017.
7. Sipas Lidhjes 2 të vendimit nr. 965, datë 10.08.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015”, nga partitë politike që janë pjesë e koalicionit ABEOK, subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore të vitit 2015 kanë qenë vetëm Partia Ora e Shqipërisë dhe Partia Konservatore² të cilat respektivisht kanë marrë 10,754 (0.69%) dhe 7,357 (0.47%) vota në shkallë vendi.

² Përfaqësuesi i koalicionit ABEOK dështoi të provonte në seancën publike të datës 30.03.2021 në KAS nëse Partia Kombëtare Konservatore Albania është i njëjti person juridik me Partinë Konservatore pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore të vitit 2015.

8. Sipas Lidhjes 2 të vendimit nr. 555, datë 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017”, nga partitë politike që janë pjesë e koalicionit ABEOK, subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2017, nuk ka qenë asnjëra prej tyre.
9. Sipas dokumentit shkresor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me titull “Zgjedhjet Vendore 2019 – Të dhënat për Votat e Vlefshme për Kandidatët për Këshill në Rang Vendi”, nga partitë politike që janë pjesë e koalicionit ABEOK, subjekt zgjedhor që plotëson në mënyrë kumulative kushtet që mos ketë qenë pjesëmarrës në zgjedhjet e viteve 2015 dhe 2017, por të ketë qenë subjekt zgjedhor në zgjedhjet e vitit 2019, është vetëm Partia Emigracionit Shqiptar që ka marrë në rang kombëtar 192 (0.03%) vota. Për shkak të parashikimit në pikat 1 dhe 2 të nenit 180 të K.Zgjedhor se *“1. Zbatimi i nenit 88 të këtij ligji për financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të tij bëhet duke kryer përllogaritjet në bazë të rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore të vitit 2015 dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. 2. Për secilën parti përfshihet në përllogaritje shifra që pasqyron numrin më të lartë të votave që partia ka marrë në njëën nga këto dy zgjedhje, kur ajo është jo më e vogël se 1 për qind e votave të vlefshme në zgjedhjet përkatëse. Në përllogaritje përfshihet edhe rezultati i subjekteve zgjedhore, që nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje, por që kanë marrë pjesë në zgjedhjet vijuese dhe që plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 88 të këtij ligji për kufirin prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara prej tyre”*, Partia Ora e Shqipërisë nuk i plotëson këto kushte në mënyrë kumulative pasi ka qenë subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet vendore të vitit 2015. Megjithatë, ky subjekt zgjedhor edhe pse ka qenë pjesëmarrës në zgjedhjet vendore të vitit 2019, ka marrë 3377 (0.44%) vota në shkallë vendi.
10. Siç vihet re qartësisht, asnjë nga partitë politike pjesë e koalicionit ABEOK, pavarësisht pjesëmarrjes në ndonjë apo nga disa prej zgjedhjeve të viteve 2015, 2017 apo 2019, asnjëherë nuk kanë mundur të plotësojnë kushtin për të *“... marrë jo më pak se 1 për qind të votave në shkallë vendi ...”*. Është pikërisht ky shkak që partive politike pjesë të koalicionit ABEOK nuk i jep të drejtën për të përfituar financim nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje edhe pse janë pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
11. KAS gjen me vend të arsyetojë edhe analogjinë që u përdor nga përfaqësuesi i koalicionit ABEOK në lidhje me subjektin zgjedhor Partia Bindja Demokratike. Në lidhje me këtë subjekt zgjedhor, duke iu referuar dokumentit shkresor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me titull

“Zgjedhjet Vendore 2019 – Të dhënat për Votat e Vlefshme për Kandidatët për Këshill në Rang Vendi”, rezulton që në zgjedhjet vendore të vitit 2019 të ketë marrë 20,350 vota (2.67%) në shkallë vendi dhe për rrjedhojë të ketë plotësuar të tre kushtet kumulative të nenit 180 të K.Zgjedhor, pra që nuk ka qenë subjekt zgjedhor në zgjedhjet e viteve 2015 dhe 2017, ka qenë subjekt zgjedhor në zgjedhjet e vitit 2019, si dhe ka marrë jo më pak se 1% të votave në shkallë vendi në këto zgjedhje. Është pikërisht kjo baza ligjore sipas të cilës subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike ka përfituar fonde nga Buxheti i Shtetit për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 dhe jo fakti që është poseduese e ndonjë mandatit deputeti siç u pretendua për analogji nga përfaqësuesi i koalicionit ABEOK.

KAS në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 172, datë 23.03.2021, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, mbështetur në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 07, datë 25.03.2021 të subjektit zgjedhor koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK);
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 172, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Ledio BRAHO - **Kryesues**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

